




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-4729/24 datë: 16.02.2024



Npi – 01/91 datë: 23.02.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 23.02.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 23.02.2024 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; znj.Kimete Ukaj, nga ZKF; Nga zyra për informimit znj.Vlora Hyseni, dhe znj.Gentiana Mehmeti.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.01.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik)
3. Informatë për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për 2022,
4. Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024,
5. Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e qmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”.
6. Prop-vendim për caktimin e çelësit për zgjedhjen e komisioneve për ndarjen e çmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”.
7. Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (pas diskutim publik),
8. Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (pas diskutim publik),
9. Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 29.01.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

****Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.01.2024.**

Pika 2

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, (pas diskutimit Publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.
znj,Kimete Ukaj, ZKF; Përshëndetje, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Financat, publike ne e kemi përgatitur draftin e kësaj rregullore të cilën e keni marrë me kohë. Propozimet që kanë rrjedhë nga diskutimi publik janë inkorporuar në draft siç janë: lirimi për familjen e ngushtë të veteranëve, pagesat në Çerdhe, si dhe taksa për guroret. Këto janë në vija të trasha, nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, te rregullorja, familja e ngushte e veteranit përfshihet e jo edhe familja e të burgosurit politikë jo. Te neni 3.4.1 a është gabim teknik, apo si qëndron kjo. Unë propozoj që me u perfshi edhe familja e ngushtë e të burgosurve politikë, kjo pastaj duhet të vazhdoj edhe te neni 12.1.6 që të përfshihet edhe familja e ngushtë e të burgosurve politikë. Te gurthyesit nevojitet edhe një sqarim me na dhënë drejtori i DPUKGJ-së.

z.Grejtalb Emimi, DPUKGJ; Komuna e Shtimes është një ndër Komunat që më së shumti e shfrytëzon gurin, mirëpo krahas kësaj ne kemi edhe dëmtim të madh të rrugëve lokale nga peshat e rënda. Ne e dimë që kanë edhe obligime të tjera Kompanitë por këta paguajnë vetëm një taksë prej 35 euro, e që është shumë e vogël në raport me dëmtimet që i shkaktojnë, qoftë në rrugë, në ambient ose në shfrytëzimin e gurit si lëndë të parë. Gurthyesit nuk e kanë kapacitetin e nejtë të veprimit dhe ne e kemi propozuar një përshkallëzim të taksës nga 1000 euro deri në 20.000 euro. Edhe tjetra është se dy kompanit më të mëdha në Komunën tonë e eksploatojnë gurin te ne por bazën e kanë në Komunat e tjera e që ne si komunë kemi dëme enorme në ujëra, lumenj, rrugë, ambient, gjelbrim etj. Është mbajtur një dëgjim publik me kompanitë e gurthyesve por në dëgjim kanë qenë vetëm 4-5 operatorë ekonomik.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, e mirpresim rregulloren, arsyetimi është i mirë në nivel. Mendoj se duhet me gjetë një formulë aq sa minon aq edhe me paguar, meqenëse ai atë material shfrytëzon. Mendoj se kjo kryesisht varet se sa material shfrytëzon aq edhe me paguar. Qysh bëhet caktimi nga 1000 deri 20.000 euro, është mirë me gjetë një formulë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve, prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2024, me propozimet që kanë dalë nga diskutimi publik e që janë inkorporuar në draft, si dhe me propozimin që te neni 3.4 dhe 12.1.6 të futet edhe lirimi: “ I burgosuri politik, prindërit dhe fëmijët”.**

Pika 3

Informatë për zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për 2022

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.
znj,Kimete Ukaj, ZKF; Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar. Në vazhdim lexoi informatën në pika kryesore (shih dokumentin), nëse ka pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Është obligim ligjor, nuk kemi shumë se çka diksutojmë. Janë 12 të gjetura 6 të reja 6 të përsëritura.

Pika 4

Prop-Vendim për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha znj.Kimete Ukaj.
znj,Kimete Ukaj, ZKF; Ligji për financa publike e lejon bartjen e të hyrave nga viti paraprak, në këtë rast nga 2023 në vitin 2024. Këto mjete barten për shpenzime në vitin 2024 ku ne i kemi paraqitur në tabelën të cilën e keni marrë me material së bashku me ftesën. Propozimet janë dhënë për vazhdimin e projekteve ekzistuese dhe jo për projekte të reja sepse nuk na lejon ligji. Në vazhdim i lexoi ndarjet buxhetore sipas tabelës nëpër kategori ekonomike. Total për bartje janë: 628.753,06 euro që duhet të barten nga viti 2023 në vitin 2024. Të hyrat janë rritur mbi 400.000 euro.

znj. Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë nuk pajtohem me këtë ndarje sepse nuk ka këtu investime kapitale në tabelë, unë nuk po shohë projekte kapitale.

znj. Kimete Ukaj, ZKF; Projekte kapitale janë blerja e automjeteve dhe projektet me bashkëfinancim.

z. Përparim Ramusa; Grejtalbin me falenderu për prezencën, por drejtori Administratës kërkon mjete e drejtori nuk është prezent edhe drejtoresha e Arsimit po ashtu, kërkohen mbi 600.000 euro e drejtorat nuk janë prezent. Ndërkaq që u kan tepruar mbi 180.000 euro. Unë jam “kundër” por do ta diskutojmë në Kuvend.

z. Kadri Emini; Përshëndetje, kjo tabelë është bërë në harmoni me kërkesat e drejtorëve. Mendoj se është mirë që drejtorët me dhënë sqarime në Kuvend. Ne e dimë që drejtorët bëjnë luftë për sa më shumë mjete. Blerja e veturave ka qenë e detyrueshme qysh në vitin e kaluar.

z. Lumni Amrushi; Po e vazhdoj ku e la Kadriu, ata drejtorat i kanë harmonizuar mes veti por nuk i kanë harmonizuar me neve. DKRS-ja ka bërë kërkesë për më shumë mjete se sa që ka pas të lejuara, lidhur me thirrjen publike për OJQ-të.

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Drejtorët duhet me qenë prezent në mbledhjen e Kuvendit. Në vazhdim Konstatoj Kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024, me propozimin që drejtorët me marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit dhe me i dhënë arsyetimet për mjetet e kërkuara.**

Pika 5

Prop-Vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e qmimeve “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi”

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Ekzekutivi le ti sjellë emrat në Kuvend dhe Kuvendi i zgjedhë anëtarët nga Kuvendi.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për formimin e Komisioneve për ndarjen e qmimeve: “Nderi i Qytetit” dhe “Qytetar Nderi” me propozimin që në Kuvend me i sjellë emrat e anëtarëve të komisionit nga ekzekutivi dhe shoqëria civile.**

Pika 6

Prop-vendim për caktimin e çelësit për zgjedhjen e komisioneve për ndarjen e çmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Sipas vendimit të mëparshëm të Kuvendit, qelësin e kemi pas që Komisioni të jetë i përbërë prej 5 anëtarëve. Nga Kuvendi 1 anëtar nga Pozita dhe 1 anëtar nga opozita, propozoj që të shkojmë edhe kësaj radhe në të njëjtën mënyrë.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e strukturës (Qelësin) të përbërjes së Komisioneve për ndarjen e çmimeve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon: Nga dy (2) anëtarë të Komisionit zgjidhen nga Kuvendi (1-Pozita dhe 1-Opozita), Nga dy (2) anëtarë të emëruar nga Kryetari i Komunës, dhe një (1) anëtar i Komisionit dërgohet nga Shoqëria Civile (OJQ) Komuna e Shtimes.**

Pika 7

Draft-Rregullore Komunale për Transparencë, (pas diskutim publik)

Kryesuesi, z. Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Lulzim Sahitit.

z. Lulzim Sahiti, zyrtar i DKA; Përshëndetje, materialin e keni marrë me kohë. Ne e kemi përgatitur këtë Draft-rregullore për Kuvend, dhe sipas ligjit edhe vendimit të Kuvendit e kemi nxjerrë në diskutim publik. Propozimet i kemi marrë nga diskutimi publik dhe i kemi inkorporuar në dokument. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit për miratim të Draft-Rregullores Komunale për Transparencë, nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Rregullores Komunale për Transparencë, me propozimet nga diskutimi publik.**

Pika 8

Draft-Plani i veprimit për transparencë komunale 2024-2028, (pas diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Planit të Veprimit Komunale për Transparencë, me propozimet nga diskutimi publik.**

Pika 9

Draft-Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për diskutim publik të Draft-Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026, Bartëse e procesit të diskutimit public është Drejtoria Komunale për Arsim në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 11:21h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

